



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

DATË/A:	22.01.2020
REFERENC-Ë:	913 / 19
PËR/ZA/TO:	AK – “Ministria e Drejtësisë” OE – “Profitech” sh.p.k - Prishtinë
NGA/OD/FROM:	Nuhi Paçarizi Kryetar i Panelit Shqyrtues-OSHP
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	N J O F T I M

Operatori Ekonomik: OE - “Profitech” sh.p.k - Prishtinë si palë e pa kënaqur më datën: 12.12.2019, ka parashtruar ankesë me nr. 913 / 19, pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull: “Furnizimi me automjet për transportin e veturave” me nr.prok: 21500-19-7374-1-1-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - “Ministria e Drejtësisë”, duke pretenduar se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së,

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimin të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë: 16.12.2019, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar procesin e aktivitetit të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve ankimore të OE : “Profitech” sh.p.k - Prishtinë.

Eksporti i OSHP-së më datën: 24.12.2019, ka dorëzuar raportin me të gjitha sqarimet dhe rekomandimet e tij lidhur me ankesën e lartpërmendur, me ç’rast ka vlerësuar se ankesa e OE: “Profitech” sh.p.k - Prishtinë është pjesërisht si e bazuar ndërsa rrjedhimisht ka rekomanduar panelin shqyrtues që njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit të mbetet në fuqi.

Me datën: 24.12.2019, Autoriteti Kontraktues: AK - “Ministria e Drejtësisë” si dhe parashtruesi i ankesës: OE - “Profitech” sh.p.k – Prishtinë e kanë pranuar raportin e ekspertizës, lidhur me

aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi me automjet për transportin e veturave” me nr.prok: 21500-19-7374-1-1-1.

Autoriteti kontraktues AK- “Ministria e Drejtësisë” përmes parashtresës së datës: 03.01.2020, pas pranimi të raportit të ekspertit të OSHP-së ka njoftuar OSHP-në, se **PAJTOHET** me mendimin e dhënë të ekspertit të OSHP-së në raportin e datës: 24.12.2019.

Operatori ekonomik: OE “Profitech” sh.p.k – Prishtinë përmes parashtresës së datës: 27.12.2019 ka njoftuar OSHP-në, se **PAJTOHET** me mendimin e dhënë të ekspertit të OSHP-së në raportin e datës: 24.12.2019.

Paneli Shqyrtues, njofton OE ankues dhe Autoritetin Kontraktues, se konform nenit 115 pika 3 të LPP-së, procedura e ankesës përfundon në këtë fazë. Autoriteti Kontraktues: AK- “Ministria e Drejtësisë” lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi me automjet për transportin e veturave” me nr.prok: 21500-19-7374-1-1-1, që **njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit të mbetet ne fuqi** sipas rekomandimeve të ekspertit të OSHP-së.

Paneli Shqyrtues, kërkon nga Autoriteti Kontraktues, zbatimin e rekomandimit të ekspertit të OSHP-së, në afat prej 10 ditësh ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Operatorit ekonomik ankues OE- “Profitech” sh.p.k – Prishtinë konform nenit 118 pika 3 të LPP-së, i kthehet sigurimi i ankesës. Urdhërohet OE ankues që konform nenit 33 pika 6 e Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Përbërja e Panelit Shqyrtues:

z. **Nuhi Paçarizi**  Kryetari i Panelit Shqyrtues,

z. **Blerim Dina**  Referues,

z. **Goran Milenković**  Anëtar.